

## NJË HISTORI E SHKURTËR RECEPTIMI: VEPRA E ISMAIL KADARESË NË ITALI

Anxhela LEPURI

Punim studimor

**Përmbajtje e shkurtër:** Ismail Kadare, edhe pse një shkrimtar i njohur ndërkombëtarisht, veprat e të cilit janë përkthyer në shumë gjuhë, nuk ka qenë objekt i një vëmendje të madhe nga ana e kritikës italiane. Një lagunë jo pak e rëndësishme nëse konsiderohet jo vetëm rëndësia e këtij autori në vetvete, por mbi të gjitha fakti se vepra e tij është shprehur e një kulture, e cila me Italinë ka pasur një raport thelbësor. Është e veçantë që në Itali, vend i cili në të shkuarën ka qenë një kullë shpëtimi për letërsinë shqiptare, Kadare të jetë përkthyer për një kohë të gjatë nga një gjuhë e dytë dhe jo nga gjuha origjinale e veprave të tij. Vetëm gjatë këtyre viteve të fundit kanë dalë disa botime të librave të shkruar rishtas nga autori, të përkthyer drejtpërdrejt prej shqipes, por përkthimet e vjetra mbesin gjithmonë ato, të dorës së dytë, të cilat rezultojnë të jenë një pengesë për kuptimin e veprës së Kadesë. Qëllimi ynë në këtë studim është të bëjmë një histori të shkurtër të procesit editorial të veprës së Kadesë në Itali.

**Fjalë çelësa:** Kadare, receptim, Itali, polemika, përkthime.

Në ndryshim nga studimet e tjera në fushë të albanologjisë, të cilat janë pozicionuar si studime me një objekt të qartë studimor nga studiuesit dhe katedrat perëndimore që nga shekulli i romantizmit evropian, vëmendja për letërsinë shqiptare do të jetë tepër e vonët. Përveç prodhimit letrar të Jeronim De Radës, Fan S. Nolit, Migjenit dhe At Gjergj Fishtës, kanë qenë të paktë autorët e tjerë shqiptarë që janë njohur edhe përtej kufirit të gjuhës

shqipe dhe kanë ngjallur interes studimor. Shkrimtari Kadare është padyshim një prej shkrimtarëve më të mëdhenj të letërsisë shqipe, i cili ka marrë një vëmendje të veçantë edhe nga studiuesit e huaj.

Interesave të mëparshme të albanologjisë tradicionale, të cilat fokusoheshin në çështje të gjuhës shqipe, të eposit heroik legjendar, të kanunit etj., me kalimin e viteve atyre iu shtua edhe letërsia e Ismail Kadaresë. Kadare është një shkrimtar me një fizionomi të larmishme, një autor që karakterizohet nga një forcë e veçantë krijuese, i aftë të rikuptimësojë mitet dhe legjendat e Shqipërisë, duke evokuar motive stërgjyshore, siç është sakrificat e ndërtimit (romanet *Ura me tri harqe* dhe *Piramida*); mitin e ringjalljes (*Kush e solli Doruntinën*); konfliktin mes nevojave të njeriut dhe ligjeve të kanunit, vlerën e jetës, çmimin e vdekjes, taksën e gjakut, kultin e besës (*Prilli i thyer*). Kadare është autori që ka hetuar raportin mes jetës dhe vdekjes (*Gjenerali i ushtrisë së vdekur*); autori që ka rievokuar dramat e mëdha të së shkuarës (*Kështjella*) dhe të së tashmes (*Dimri i vetmisë së madhe*, *Përbindëshi*, *Nëntori i një kryeqyteti*, *Koncert në fund të dimrit*). Kadare është autori që u ka prezantuar të huajve veset dhe virtytet e popullit të vet, traditat shekullore (*Dasma* dhe *Breznitë e Hankonatëve*). Kadare është autori që, me një stil përplot metafora dhe thellësisht simbolizues, ka përshkruar ngjytjen dhe rënien, humbjen dhe shpresën e burrave të kohës së tij (romanet *Hija*, *Dosja H*, *Shkaba*, *Pasardhësi*).<sup>1</sup> Por, paçka se Kadare është një autor kaq i larmishëm e që në shumë vende evropiane ka tërhequr një vëmendje tepër të madhe, në kulturën italiane, e më konkretisht në kritikën letrare italiane, ky autor nuk ka marrë një vëmendje të veçantë, për të mos thënë se është neglizhuar në mënyrë të vazhdueshme. Kjo neglizhencë, e cila me shumë gjasa mund të ketë qenë e dyanshme, përbën sot për studimet albanologjike në Itali një problem jo fort të lehtë.

Siç dëshmon studiuesja Pelusi<sup>2</sup>, përkthimet e para italiane dhe franceze të Kadaresë janë shfaqur rreth fundit të viteve '60 në Tiranë nga shtëpia botuese "Naim Frashëri": *Poema dhe poezi të zgjedhura*, me një parathënie nga Adriatik Kallulli (1968), *Le Général de l'armée morte* (1968), dhe si përfundim *Il generale dell'esercito sepolto* (1974). Pra, për veprën *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* ka ekzistuar një përkthim italian i bërë direkt nga gjuha shqipe, por ky tekst nuk është marrë në konsideratë dhe është zhdukur nga qarkullimi. Shënimi i parë që është gjendur për veprat e

<sup>1</sup> Giuseppina Turano, *Ismail Kadare, scrittore d'Albania, un breve profilo*, në *Leggere Kadare, Critica, Ricezione, Bibliografia*, Biblion edizioni, Milano, 2007, f. 29.

<sup>2</sup> Simonetta Pelusi, *Kadare in Italia. Saggio di bibliografia orientativa (1968-2007)*, në *Leggere Kadare, Critica, Ricezione, Bibliografia*, Biblion edizioni, Milano, 2007, f. 160.

Kadarese në studimet italiane është ai i Umberto Bosco-s, në *Institutin e Enciklopedisë italiane (Istituto della Enciclopedia italiana)* më 1968, i cili në *Leksikon universal italian (Lessico universale italiano)* shkruan: “Interpretuesi më i madh i miteve kombëtare dhe i historisë së popullit të tij është Ismail Kadareja”.<sup>3</sup> Një vit më vonë, më 1969, në antologjinë *Tre poetë të Shqipërisë së sotme*, Joice Lussu zgjedh Kadarenë si një prej tre shkrimtarëve të saj të preferuar mes Migjenit dhe Siliqit.

Studimet italiane mbi Kadarenë tregojnë një vonesë në raport me ato franceze, por edhe angleze e madje edhe ato spanjolle e ruse. Romani i parë i publikuar *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, i dalë për herë të parë në shqip në Tiranë më 1963, do të shfaqet në Itali më 1982, i përkthyer nga frëngjishtja, me një vonesë të jashtëzakonshme në raport me daljen e tij në Francë, në 1970. Përveç vonesës së konsiderueshme, studimet mbi Kadarenë në Itali kanë pasur një tjetër diferencë, janë nisur nga ambiente parashkencore dhe për një kohë të gjatë janë dalluar për një karakter kritik dhe kundërthënës. Vepra e Kadarese në Itali për një kohë të gjatë ka qenë çështje e *communis opinio*.<sup>4</sup> Dhe me gjasë motivet e polemikës mund të kenë qenë: vetë italianët në veprat e Kadarese, e vërteta historike dhe e vërteta letrare, ideologjia dhe letërsia, dhe sigurisht simpatia dhe indiferenca e vetë shkrimtarit.<sup>5</sup> Imazhi i italianit në veprën e Kadarese, në veçanti imazhi i ushtarit dhe i gjeneralit italian nga Lufta e Dytë Botërore, të pranishëm si personazhe në *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* dhe *Kronikë në gur*, nuk mund të kalohej në mënyrë neutrale. Shqetësimi për të ashtuquajturën zgjedhje tendencioze e antagonistit historik nga ana e Kadarese, ka ardhur nga periferia e studimeve letrare italiane dhe ka vazhduar të jetë në të njëjtën vazhdimësi për një kohë të gjatë. Interesat që u shfaqën në periudhën e parë për shkak të subjektivitetit të lexuesit dhe opinionëve të ndjeshme italiane, janë gjithsesi

<sup>3</sup> Shaban Sinani, *Kadare në studimet italiane*, në *Studimet albanistike në Itali/ Albanistic studies in Italy/ Gli studi albanistici in Italia*, Conferenza scientifica internazionale, Prishtinë, 2020, f. 166.

<sup>4</sup> Ibid.

<sup>5</sup> Kur është pyetur mbi përkthimet nga gjuhët e dyta, Kadare është përgjigjur: “Gj. Marinaj: Disa nga librat tuaj janë përkthyer nga shqipja në frëngjisht, dhe mëpastaj nga frëngjishtja në gjuhë të tjera. Si ndikojnë këto përkthime sekondare në cilësinë e veprës letrare? I. Kadare: Pjesa më e madhe e përkthimeve të veprave të mia, ato që konsiderohen si më të mirat, janë përkthyer drejtpërdrejt prej shqipes në gjermanisht, frëngjisht, spanjisht. Ndërsa për ato që janë përkthyer në anglisht, disa janë përkthyer nga origjinali shqip e disa të tjera nga frëngjishtja. Në gjuhët e tjera, gjithashtu, pak a shumë janë përkthime nga origjinali ose nga frëngjishtja më së shumti.” Në: Gjekë Marinaj, *An Interview with Ismail Kadare*, Translation Review, 76:1, ff.11-16, 2008, DOI: 10.1080/07374836.2008.10523976.

domethënëse përse i përket receptimit të veprës së Kadaresë, sepse vepra letrare nuk është një objekt i izoluar që i ofron të njëjtin imazh çdo lexuesi në çdo kohë. Ajo është një monument që zhvillon natyrën e saj të pakohshme nëpërmes një monologu. Çdo lexues investon në një vepër letrare shijen e së tashmes. Dhe, si rrjedhojë, historia e letërsisë nuk mund të jetë unike, një e vetme, qoftë edhe nga pikëpamja sinkronike. Ai që është unik është vetëm teksti, me të cilin do të dialogojnë vepra dhe lexues të ndryshëm në kontekste të ndryshme.<sup>6</sup> Që nga fillimet e saj letërsia shqipe, përherë e izoluar, është karakterizuar nga moskomunikimi. E shkruar dhe e publikuar historikisht në 'ishuj' kulturor jokomunikativ me njëri-tjetrin, ajo nis të komunikojë normalisht vetëm përreth viteve '20-'30 të shek. XX. Pas vitit 1945, pra disa dekada më vonë, regjimi komunist e ndërpret befas komunikimin normal letrar të sapo stabilizuar, duke e detyruar letërsinë shqipe të rikthehet sërish në një 'ishull' jo komunikues. Pikërisht në këtë periudhë ndërpritet komunikimi me letërsinë shqipe të Kosovës nga njëra anë dhe me atë të diasporës nga ana tjetër. Në të njëjtën periudhë lexuesi shqiptar brenda Republikës së Shqipërisë i humbet kontaktet jo vetëm me letërsinë bashkëkohore të huaj, por ç'është më e rëndësishmja edhe me një pjesë të mirë të traditës letrare shqipe.

Ndaj mendojmë se dinamikat e receptimit të veprave të letërsisë shqipe në Itali apo gjetkë, janë një hap i rëndësishëm që studimet shqiptare duhet ta hedhin, për të kuptuar mbi të gjitha se në çfarë mase konteksti historik, politik dhe social i Shqipërisë dhe i Italisë ka ndikuar dhe si rrjedhojë ka përcaktuar shpërndarjen e këtyre veprave. Shembulli ynë në këtë herë që për Kadarenë, për faktin se vepra e tij është shënuar nga një problem i cili vështirë të përcaktohet i ç'natyre është. Fakti që veprat e tij për një kohë të gjatë janë përkthyer nga gjuha franceze dhe jo nga gjuha origjinale e veprave të tij, që është shqipja, ka ngjallur interesin tonë për të vlerësuar këto përkthime në raport me tekstet origjinale. Shpesh përkthimet italiane largohen 'rrezikshëm' nga origjinalet, çka sugjeron se duhen marrë në konsideratë edhe përkthimet nga shqipja në frëngjisht. Studiuesi Belluscio<sup>7</sup>, i cili e ka identifikuar më parë këtë problem, ka zbuluar se 'liritë përkthimore', në krahasim me veprat origjinale, janë pothuajse të gjitha fryt i përkthyesit të parë, pra të Jusuf Vrionit, ndërsa ribotimet e mëvonshme, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë, kanë përfutur ndryshime që konsistojnë në

<sup>6</sup> Hans R. Jauss, *Perché la storia della letteratura*, Guida Editori, Napoli, 2001, f. 38.

<sup>7</sup> Giovanni Belluscio, *Leggere Kadare in italiano tra riscritture e "mistificazioni"*, në *Leggere Kadare, Critica, Ricezione, Bibliografia*, Biblion edizioni, Milano, 2007, f. 32.

rishkrime dhe rregullime të teksteve nga ana e autorit, dhe jo vetëm të teksteve të shkruara gjatë regjimit, por edhe të teksteve të shkruara pas shpërnguljes në Francë. Sidoqoftë, analiza e përkthimeve në italisht, duhet domosdoshmërisht të kalojë si fillim përmes analizës së përkthimeve në frëngjisht.

Në rrugëtimin krijues të Ismail Kadarese duhet të bëhen llogaritë edhe me ndërhyrjet e vazhdueshme të tij në veprat e publikuara. Kadare ka operuar me kohën ndërhyrje të vazhdueshme limimi në veprat e tij, si të atyre në poezi ashtu edhe të atyre në prozë, duke modifikuar leksikun, stilin, strukturën, dhe për këtë arsye një lexim tërësor i thelluar dhe kritik i prodhimit të tij letrar duhet të marrë në konsideratë këto ndërhyrje, të cilat kanë modifikuar strukturën origjinale të veprave. Këto ndryshime të bëra mund të ndahen në tri lloje: a) të ndikuara nga normat e reja drejtshkrimore të vendosura nga Kongresi i Drejtshkrimit më 1972; b) të ndikuara nga ngjarjet e politikës shqiptare, nga ndryshimet e së cilës edhe artistët ishin të detyruar të përshtateshin; c) të bëra thjesht për hir të një ndryshimi strukturor formal, me karakter kreativ artistik. Dy motivet e para janë të diktuar nga ndikime të jashtme, ndërsa motivi i tretë është i lidhur thellësisht me evolucionin e mendimit dhe vizionit krijues të shkrimtarit.

Vlen të theksojmë se përkthimet në frëngjisht janë në njëfarë mënyre dinamike, që do të thotë se janë përshtatur me ndërhyrjet e mëvonshme të autorit, ndërsa përkthimet në italisht mbeten fikse, besnike të botimeve të para, të pandryshuara nga modifikimet që me kalimin e kohës kanë modifikuar pjesërisht tekstet origjinale.<sup>8</sup> Është e vlefshme të nënvizohet se pas 15 vjetësh politikën e përkthimeve nga shqipja në italisht kanë ndryshuar dhe janë përmirësuar. Por, ky aktivitet përkthyes, i kryer në vitet e fundit, është i pavlefshëm deri diku, sepse shumica e teksteve kryesore janë përkthyer dhe vazhdojnë të shpërndahen në Itali mbi bazën e versionit francez, një praktikë e mjerueshme përkthimi që varfëron njohuritë dhe debatet rreth origjinaleve, duke zhvlerësuar një kuptim më të artikuluar dhe duke shkaktuar, me praninë e një ndërmjetësi të padobishëm, keqkuptime të shumta në gjuhën pritëse.<sup>9</sup> Lexuesi italian me të drejtë mund të mendojë se Kadare si gjuhë të shkrimit të veprave të veta ka frëngjishten, sepse, edhe pse ai ka rishikuar e rishikuar një pjesë të konsiderueshme të veprave më të rëndësishme, këto të fundit vazhdojnë të rishtypen sikur të qe botimi i parë,

<sup>8</sup> Ivi, f.33.

<sup>9</sup> Monica Genesin, *Alcuni problemi linguistici nella traduzione italiana del racconto "Ikja e shtërgut"* (La fuga della cicogna) di Ismail Kadare, në *Leggere Kadare, Critica, Ricerche, Bibliografia*, Biblion edizioni, Milano, 2007, f. 32.

dhe të mos ishte për ndonjë datë të fshehur këtu-atje, mund të konsideroheshin madje si botime aktuale. Kujtojmë se mbi përkthimet franceze të Jusuf Vrionit është bazuar pjesa më e madhe e përkthimeve të Kadaresë në Evropën Perëndimore, mjafton të përmendim përkthimet në anglisht, apo edhe vetë përkthyes të rëndësishëm, si David Bellos, të cilët definohen si ‘ri-përkthyes’.

Bëhet fjalë për një problem filologjik, dhe për këtë nevojitet të merret në konsideratë çdo variant kronologjik, edhe modifikimet e mëvonshme të bëra nga autori apo censura, në mënyrë që të krijohet një kuadër sa më i detajuar i të gjitha fenomeneve dhe shkaqeve që kontribuan në ‘fatkeqësinë’ e këtij autori në një periudhë të caktuar historike, që të mund të fitohet një besueshmëri historiko-shkencore. Ky është një sektor studimesh që filologjia në Shqipëri ende nuk e kultivon. Në Itali u quajt kritika e variantit dhe më vonë në Francë, në vitet ’70, mori emrin si kritikë gjenetike. Kritika e varianteve është një formulim i studiuesit italian Gianfranco Contini, i cili, që nga vitet ’30-’90 të shekullit të shkuar, është marrë me studime filologjike, duke u përqendruar te dorëshkrimet. Ndërkohë termi kritikë gjenetike u përdor për herë të parë në 1979 nga Louise Hay<sup>10</sup>. Kritika gjenetike implikon një objektiv të ri studimi, jo vetëm teksti, por edhe shkrimi, jo vetëm rezultati, por edhe procesi janë të rëndësishëm, e kështu përdor mjete të semiotikës, linguistikës, psikanalizës dhe narratologjisë.

Studimi i receptimit të veprës së Kadaresë në Itali, vlen gjithashtu të kryhet në një perspektivë historike, që të jetë njëkohësisht edhe ndërkulturore, pra, që të marrë në konsideratë të dyja sistemet socio-kulturore të përfshira. Studimi i receptimit transformohet në një tentativë për t’i rikthyer lexuesit zërin e tij dh me të, rolin e tij prej autori, sepse, duke qenë lexuesi një agjent që vepron në tekst – atje ku është e mundur – veprimi i tij duhet të merret në konsideratë për të përcaktuar nëse dhe në ç’mënyrë ka ndryshuar kuptimin e tekstit pavarësisht qëllim-synimeve të autorit. Vetëm në shek. XX, sidomos në shtatëdhjetë vitet e fundit, si lexuesi, si një nga elementët e skemës së komunikimit, ashtu edhe leximi si proces, janë vendosur në qendër të vëmendjes. Liritë dhe përgjegjshmëritë e lexuesit u vendosën në qendër të teorive të receptimit. Për shkollën e Kostancës, leximi ishte i varur nga pritshmëritë e lexuesit, nga bagazhi i tij individual e kulturor. Mbushja e hapësirave të bardha të një teksti gjatë ndërveprimit me lexuesin ndryshon po ashtu edhe konceptin mbi tekstin, nga një entitet i

<sup>10</sup> Louis Hay, *La littérature des écrivains. Questions de Critique Genetique*, Paris, 2002, f.99.

mbyllur teksti bëhet një entitet i hapur. Zhvendosja e vëmendjes nga koncepti i lexuesit ideal në atë të konsumatorit real të tekstit letrar u ka dhënë hov teorive të dekonstruktimit dhe shkollës amerikane ‘Reader-Response Criticism’, e cila, mbi të gjitha me veprat e Stanley Fish-it, e vendos theksin tek nevoja e edukimit të lexuesit.<sup>11</sup>

Për t’u rikthyer në çështjen tonë, mendojmë se kjo qasje studimore ka një dobi dhe një vlerë pragmatike fort të rëndësishme sepse, të nisura relativisht vonë, studimet mbi Kadarenë në Itali kanë filluar të shtohen vitet e fundit. Përveç kontributeve të studiuesve italo-shqiptarë, ku dallon Matteo Mandalà me artikujt dhe monografitë e tij; përveç ndihmesës së një gjenerate të re kërkuesish shqiptarë, rezultati më i rëndësishëm i studimeve kadareane në Itali është kthimi në vëmendjen akademike dhe të universiteteve. Studimet mbi Kadarenë dhe veprën e tij e kanë tejkaluar fazën e polemikave dhe të rishikimeve. Për shkak të raporteve ‘problematike’ të veprës së tij me lexuesin italian, ka qenë e nevojshme përgatitja dhe publikimi i një bibliografie orientuese mbi Kadarenë kryer nga Simonetta Pelusi (2007), për të ndihmuar ata që janë të interesuar për veprën e tij. Të paraprira nga artikujt dhe studime autorësh, të cilët të zhgënjyer nga mënyra sesi gjenerali, prifti dhe ushtari italian shfaqeshin në romanin *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, janë bërë trajtesa të vlefshme për të shuar këto polemika (Paolo Muner, *Una domanda a Ismail Kadare: per chi è morta l’armata del Generale*; Tullio Mereu, *Da Tirana a Fushë-Gurra: la storia della colonna Gamucci*; Antonio Magagnino, *L’eccidio della Colonna Gamucci: storia dei carabinieri reali in Albania comandati dal colonnello Giulio Gamucci*). Studimet dedikuar veprës së Kadaresë janë thelluar falë kujdesit të studiuesve të departamenteve universitare dhe qendrave kërkimore. Në vijë kronologjike, ka qenë Universiteti i Kalabrisë i pari që ka sugjeruar kërkimet mbi veprën e Kadaresë. Së fundmi, Universiteti Ca’Foscari i Veneçias i ka institucionalizuar studimet mbi Kadarenë me veprimtari shkencore italiane dhe ndërkombëtare.

### Bibliografi

Giuseppina Turano, *Ismail Kadare, scrittore d’Albania, un breve profilo*, në *Leggere Kadare, Critica, Ricezione, Bibliografia*, Biblion edizioni, Milano, 2007.

Gjeke Marinaj, *An Interview with Ismail Kadare*, Translation Review, 76:1, pp.11-16, 2008, DOI: 10.1080/07374836.2008.10523976.

<sup>11</sup> Francesco Muzzioli, *Le teorie della critica letteraria*, Carroci, Roma, f. 181.

Giovanni Belluscio, *Leggere Kadare in italiano tra riscritture e "mistificazioni"*, në *Leggere Kadare, Critica, Ricezione, Bibliografia*, Biblion edizioni, Milano, 2007.

Monica Genesin, *Alcuni problemi linguistici nella traduzione italiana del racconto "Ikja e shtërgut" (La fuga della cicogna) di Ismail Kadare*, në *Leggere Kadare, Critica, Ricezione, Bibliografia*, Biblion edizioni, Milano, 2007.

Simonetta Pelusi, *Kadare in Italia. Saggio di bibliografia orientativa (1968-2007)*, në *Leggere Kadare, Critica, Ricezione, Bibliografia*, Biblion edizioni, Milano, 2007.

Shaban Sinani, *Kadare në studimet italiane, në Studimet albanistike në Itali/ Albanistic studies in Italy/Gli studi albanistici in Italia*, Prishtinë, 2020.

Louis Hay, *La littérature des écrivains. Questions de Critique Genetique*, Paris, 2002.

Hans Robert Jauss, *Toward an Aesthetic of Reception*, University of Minnesota Press, Minneapolis, 1982.

## **A SHORT HISTORY OF RECEPTION: THE WORK OF ISMAIL KADARE IN ITALY**

### **Summary**

Ismail Kadare, although a nationally acclaimed writer whose works have been translated into many languages, has not been yet the object of considerable attention by Italian critics. A very important lagoon if considered not only the importance of this author in itself, but above all the fact that his work is the habit of a culture, which with Italy has had an essential relationship. It is unusual that in Italy, a country which in the past has been a lifeline for Albanian literature, Kadare has been translated for a long time from a second language and not from the original language of his works. Only in recent years have been published some editions of latest books written by the author, translated directly from Albanian, but the old translations remains the same, which turn out to be an obstacle to the understanding of Kadare's work. This study seeks to do a brief history of reception of the editorial process of Kadare's work in Italy.